



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URBAN ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



De:	29.01.2010
Na:	
Pre:	361 D
Ce:	ST

Për: Kryeshefat Ekzekutiv të KRU-ve
Kryesuesit e Bordeve të Drejtorëve

Kopje: Ramadan Sejdiu

Udhëheqësit të Njësive për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

Rishikimi Vjetor i Tarifave të Shërbimit

Të nderuar,

Në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka në pajtim me kornizën ligjore dhe rregulatore në fuqi (*Ligji për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetillës, Kanalizimit dhe Mbeturina* si dhe *Rregulla për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit dhe Furnizimit të Ujit me Shumicë*), Zyra Rregulatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) ka rishikuar tarifat e shërbimit të përcaktuara në fund të vitit 2008 për periudhën 2009-2011.

Duke qenë viti 2009 viti i parë i aplikimit të tarifave të shërbimit të këtij cikli tarifar trevjeçar, ZRRUM ka monitoruar në mënyrë të rregullt dhe sistematike efektet e këtyre tarifave. Si rezultat i këtij monitorimi ZRRUM ka analizuar parametrat operativ, financiar, dhe në vecanti, investimet kapitale të realizuara në frymën e caceve të përcaktuara me procesin tarifar 2009-2011, dhe rrjedhimisht ka përgatitur raportet periodike ku janë prezantuar rezultatet e këtyre analizave (2 raporte periodike për efektet e tarifave për periudhat: janar-maj 2009, dhe janar-shtator 2009).

Siç jeni në dijeni, konkluzionet e këtyre raporteve si dhe gjetjet e këtyre analizave ZRRUM i ka diskutuar edhe me juve në takimet e organizuara për këtë qëllim.

Si konkluzion i përgjithshëm që ka dalë nga monitorimi i efekteve të tarifave 2009-2011, është konstatuar se në vitin 2009 ka pasur ngecje në të gjitha KRU-të në përmbushjen e caceve të përcaktuara me procesin tarifar. ZRRUM ka shprehur shqetësimin e vet me juve dhe palët tjera të interesit lidhur me këto ngecje dhe ka kërkuar në vazhdimësi nga KRU-të që të rrisin intensitetin e angazhimit me qëllim që të arrihen caqet e përcaktuara me procesin tarifar.

Megjithatë, edhe përkundër paralajmërimeve të rregullta, angazhimet tuaja kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk është arritur që të ndryshohen trendet e pakënaqshme, dhe si rezultat i kësaj treguesit kryesorë të cilët përcaktojnë performancën tuaj kanë mbetur të papërmbyshur, ZRRUM shpreh brengën e vet.

Megjithatë, ZRRUM ka marrë parasysh arsyetimet e shprehura nga KRU-të lidhur me vështirësitë objektive që kanë pasur ato në arritjen e caceve të përcaktuara, të cilat konsistojnë në:

- a. Rrethanat e përgjithshme të pafavorshme në Kosovë në vitin 2009;
- b. Mungesën e mbështetjes efikase nga mekanizmat shtetëror në ngritjen e shkallës së arkëtimit;
- c. Moszgjidhjen e problemit të rasteve sociale dhe problemit të mospagesës nga minoriteti serb;
- d. Ngritjen e tarifave të energjisë në vitin 2009 si dhe ngritjen e pritshme të të njëjtave në fillim të vitit 2010,

ZRRUM ka vendosur që tarifat e shërbimit të përcaktuara me Urdhëresat Tarifore për periudhën 2009-2011 të mbeten ashtu siç janë përcaktuar, pra të mos ndryshohen (zbriten).


Dëshiroj të theksoj se në vitin 2010 ZRRUM do të vazhdojë të monitorojë ngushtë përmbushjen e caceve të përcaktuara me procesin tarifor, dhe rrjedhimisht në rast të mospërmbushjes së këtyre caceve, ZRRUM do të korrigjojë (zbres) tarifat për vlerën e parealizuar të investimeve kapitale të planifikuara. ZRRUM nuk do të tolerojë më që në emër të rrethanave të vështira të pësojnë investimet kapitale të nevojshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit në funksion të përmirësimit të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Prandaj, kërkojmë nga KRU-të që në bashkëpunim dhe me mbështetjen e institucioneve kompetente, të angazhohen maksimalisht për përmbushjen e caceve të performancës për vitin 2010, sepse në rast të dështimit në përmbushjen e këtyre caceve ZRRUM do të jetë zbres tarifat e vitit 2011 dhe për efektet negative të kësaj zbritje KRU-të do të mbajnë përgjegjësi.

Me respekt,

Äfrim Lajçi

Drejtor i ZRRUM





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



Në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore në fuqi (*Ligji për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujës-jellës, Kanalizimit dhe Mbeturinave si dhe Rregulla për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit dhe Furnizimit të Ujit me Shumicë*),

Duke u bazuar në procesin e monitorimit të efekteve të tarifave të shërbimit të përcaktuara me procesin tarifar 2009-2011,


Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) merr këtë:

V E N D I M

Për Konfirmimin e Tarifave të Shërbimit për vitin 2010
sipas Urdhëresave Tarifore 2009-2011

- Me të cilin konfirmohen Tarifat e Shërbimit të përcaktuara me procesin tarifar për periudhën 2009-2011.
- Ky vendim është i aplikueshëm për të gjitha Kompanitë Regjionale të Ujit të licencuara nga ZRRUM.

KRU-të të cilave iu referohet ky Vendim kanë të drejtë të anohen në këtë vendim në afat prej 15 ditësh nga data e nxjerrjes së tij në pajtim me dispozitat Ligjit për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave.


Afrim Lajçi
Drejtor ZRRUM

